



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 08.01.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.01.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "H&B Consulting" Sh.p.k, për aktivitetin: "Ndërtimi i shkollës së mesme 7 Shtatori Nr. të Prok: 616 20 029 511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "H&B Consulting" Sh.p.k "e datës 08.01.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit" Ndërtimi i shkollës së mesme 7 Shtatori " Nr. të Prok: 616 20 029 511 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit , të datës 08.12.2020 te publikuara ne web-faqe te KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit te dates 08.12.2020 dhe korigjimit te publikuar me daten 06.01.2021.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **“H&B Consulting” Sh.p.k** “me datë 08.01.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i shkollës së mesme 7 Shtatori Nr. të Prok: 616 20 029 511**

' Autoriteti Kontraktues, me datë 08.01.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Nuk qendron pretendimi juaj se Autoriteti Kontraktues ka bere ndryshim ne kerkesat e dosjes se tenderit me daten 08.01.2021,pasi qe sipas kerkeses te nje OE-ik tjetër te dates 05.01.2021 e cila eshte konsideruar e arsyeshme korigjimi i kerkeses eshte publikuar me daten 06.01.2021 dhe me te njejten eshte bere edhe vazhdimi i afatit per dorezim te tendereve deri me daten 22.01.2021.Pra nuk qendron pretendimi se ju nuk mund te beni pergatitje per dorezimin e tenderit,por edhe nese kjo ndodh ju mund te kerkoni afat shtese dhe kjo do te aprovohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit